



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/42

Datë: 19.07.2021

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 43 të Statutit të komunës së Junikut të datës 29.09.2010, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të Rregullores MF Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kryetari i Komunës së Junikut, merr këtë:

V E N D I M

I. APROVOHEN, Procedurat Standarde të Operimit (PSO) të të hyrave komunale dhe menaxhimit të pasurive jo financiare kapitale dhe jo kapitale, si pjesë përbërëse e Doracakut “Libri i Proceseve”, i cili aktualisht përmban proceset e: buxhetit komunal, menaxhimit të pagave, kontratave për shërbime me marrëveshje të veçanta, shpenzimeve për mallra shërbime, shpenzimeve për avance dhe para të imët, shpenzimeve për udhëtime zyrtare, shpenzimeve për komunalitë, shpenzimeve për subvencione dhe transfere, shpenzimeve për investime kapitale, menaxhimit të projekteve, prokurimit dhe menaxhimit të kontratave. Këto procedura standarde të operimit do të shërbejnë si procedura të brendshme për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë, gjeodezia, lejet e ndërtimit, lejet e gjendjes civile, lejet, prona komunale, dhe si procedura të brendshme për evidentimin, ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurive jo financiare ashtu siç kërkohet me rregulla financiare.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga tatimi në pronë;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga gjeodezia;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga lejet e ndërtimit;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga lejet e gjendjes civile;
- PSO për regjistrimin dhe raportimin e të hyrave komunale nga prona komunale;
- PSO për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare nën 1,000€; dhe
- PSO për menaxhimin e pasurive komunale jo financiare kapitale mbi 1,000€.

III. Për zbatimin e këtij aneks vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Administratës dhe Zyrtarët publik kompetent të Komunës.

IV. Aneks vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Drejtorët e drejtorive të Komunës
- Zyrtarët kompetent të Komunës
- Arkivi i Komunës

Kryetari i Komunës
Agron Kuçi